



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 43/ Prot.
7

Tiranë, më 27.02.2026

Lënda: Raporti i Monitorimit të Buxhetit për vitin 2025.

**MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT**

TIRANË

Në mbështetje të Ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, lutemi gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të Buxhetit për vitin 2025 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Raporti i monitorimit, krahas analizës së shpenzimeve buxhetore në nivel programi përmban dhe një analizë të objektivave institucionale referuar performancës buxhetore të orientuar drejt rezultateve.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona Gaxha



PROGRAMI 01120 “VEPRIMTARI AUDITUESE E KLSH-së”

KLSH ka kryer monitorimin e buxhetit të periudhës janar-dhjetor 2025, nëpërmjet vlerësimit dhe krahasimit të performancës së fondeve buxhetore të alokuar në programin 0110 “veprimtaria audituese e KLSH-së” kundrejt realizimit faktik. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Në vijimësi dhe strukturat respektive të KLSH-së kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore më qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KLSH-së dhe Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2023-2027.

Në mbështetje të Ligjit nr.115/2024“Për buxhetin e vitit 2025”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.07.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për vitin 2025, performanca e realizimit të buxhetit, paraqitet si më poshtë:

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2025-2027 dhe është në funksion të kësaj Deklarate. Politika buxhetore e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave, si dhe prioritetëve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik 2023-2027, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE dhe të monitoruara në kuadrin e Integritimit Evropian.

“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE PËR VITIN 2025”

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Akteve Normative nr.10, datë 08.10.2025 dhe nr.11, datë 19.12.2025, është bërë miratimi i çeljes dhe rishikimit të fondeve buxhetore për vitin 2025, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Fondet e alokuara dhe realizuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për vitin 2025, paraqiten si më poshtë:

Ne mijë lekë

Kap.	Artikulli	Pershkrimi	Kod Projekti	Fakti 2024	Ligji i Buxhetit	Akt Normativ Tetor	Akt Normativ Dhjetor	Fakti 2025	%
01	600	Paga	92401AA	456,121	531,300	486,300	480,300	475,960	99%
01	601	Sigurime	92401AA	69,813	66,800	76,800	73,800	71,704	97%
	600-601		0	525,934	598,100	563,100	554,100	547,664	99%
01	602	Mallra dhe shërbime	92401AA	71,082	80,700	85,700	72,700	69,339	95%
01	605	Transferta me jashtë	92401AA	292	200	200	200	100	50%
1	606	Transferta per individë		1,151	1,500	1,500	1,500	1,164	78%
	602-605		0	72,525	82,400	87,400	74,400	70,603	95%
01	231	Pajisje informatike	M240009	0	7,000	7,000	3,800	3,742	98%
01	231	Mjete transporti	M240002	4,920	3,000	3,870	3,470	3,420	99%
01	231	Rikonst ndërtesa	M240003	0	4,000	3,130	3,130	2,658	85%
01	231	Pajisje Zyre	M240010	1,522	1,000	1,000	550	529	96%
01	230	Kosto Lokale		2,190					
01	230	TVSH		1,817					
01	230-231			10,449	15,000	15,000	10,950	10,349	95%
02	231	Grand I Huaj		2,908	273	273	273		
02	230	Financimi I Huaj		4,129		4,770	4,770	4,770	100%
		Totali	0	615,945	695,773	670,543	644,493	633,386	98%

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË KLSH-SË PËR VITIN 2025

Bazuar në Ligjin 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar për KLSH-në, fondi i alokuar për KLSH-në në vlerën për 644,493 mijë lekë përfshirë dhe grandin e huaj, është realizuar në vlerën totale për 633,386 mijë lekë ose në masën për 98 %.

Realizimi sipas zërave kryesorë të shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 99 %
- Shpenzimet e tjera operative 95 %
- Shpenzimet Kapitale ME Financim të Brendshme 95 %
- Financimi i Huaj 100 %.

Paraqitja grafike e realizimit të buxhetit 2025 në lekë.



1. Shpenzime Personeli. Llogaria 600-601.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2025 në zbatim të Ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, për zërin “Paga dhe Sigurime ” është në vlerën për 598,100 mijë lekë dhe numri i miratuar i punonjësve është 243 punonjës. Përgjatë vitit 2025, ky buxhet është rialokuar në zërin mallra dhe shërbimë në vlerën për 5,000 mijë lekë si dhe është pakësuar me akte normative. Buxheti i planifikuar në masën për 554,100 mijë lekë është realizuar në vlerën për 547,664 mijë lekë ose realizuar në masën 99 %. Krahasuar me buxhetin faktit të vitit 2024 në vlerën për 525,934 mijë lekë, shpenzimet në këtë zë janë afërsisht 4% më shumë.

2. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602.

Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2025 në zbatim të Ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, për zërin shpenzime operative, është në vlerën për 80,900 mijë lekë, ose 12 % e planit buxhetor të vitit 2025. Përgjatë vitit 2025, ky buxhet është rishpërndarë në zërin paga dhe sigurime në vlerën për 5,000 mijë lekë si dhe si dhe është pakësuar me akte normative. Buxheti i planifikuar në masën për 72,900 mijë lekë është realizuar në vlerën për 69,439 mijë lekë ose realizuar në masën 95 %. Krahasuar me buxhetin faktit të vitit 2024 në vlerën për 71,374 mijë lekë, shpenzimet në këtë zë janë afërsisht 3% më pak.

Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative e zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit në vlerën 39,582 mijë lekë dhe që përfaqësojnë 54% të shpenzimeve të planifikuara të zërit “Mallra dhe shërbime”. Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve si shpenzime për shërbimin e sigurisë, drita, ujë, telefon, kancelari, bateri për ups, shërbim printimi, mirëmbajtje automjetesh etj.

Gjithashtu në këtë zë janë përfshirë edhe shpenzimet për kremtimin e 100 vjetorit të themelimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit – një institucion që për një shekull ka kontribuar në forcimin e kulturës së llogaridhënies dhe përmirësimin e qeverisjes në menaxhimin e financave publike. Ky përvjetor përfaqëson një moment historik jo vetëm për KLSH-në, por për gjithë zhvillimin institucional të Shqipërisë moderne. E themeluar në Maj 1925, në një etapë vendimtare për konsolidimin e shtetit shqiptar, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka qenë i pranishëm në çdo fazë të transformimit të administratës publike.

Aktualisht, për vitin 2025, KLSH , ka realizuar disa procedura prokurimi në lidhje me:

-Blerie licenca IT me qëllim funksionimin optimal të pajisjeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe lehtësimin e punës së përdoruesve të infrastrukturës teknologjike të KLSH-së.

-Shërbim interneti për institucionin, mirëmbajtje ashensori, sistem alarmi, mirëmbajtje kondicionerësh, blerje kancelari, materiale pastrimi dhe disinfektimi, mirëmbaje automjete transporti, karburantetj.

3. Transferta korrente dhe të huaja. Llogaria 605.

Për periudhën raportuese 2025, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe kuotat e pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare në shumën 100 mijë lekë nga 200 mijë lekë të planifikuara.

4. Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.

Gjatë periudhës ushtrimore 2025, është dhënë Fond i Veçantë nga Ministria e Financave në vlerën 1,500 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast fatkeqësie dhe sëmundjeje vlerë e cila përgjatë kësaj periudhe është realizuar në masën për 1,163 mijë lekë osë 78 %.

5. Shpenzime për investime kapitale. Llogaria 230-231.

• Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm

Bazuar në Ligjin nr. 115/2025, “Për buxhetin e vitit 2025”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është në shumën 15,000 mijë lekë investime me Financim të Brendshëm. Përgjatë vitit 2025, ky buxhet e me akt normativ është pakësuar në vlerën për 4,050 mijë lekë. Buxheti i planifikuar në masën për 10,950 mijë lekë është realizuar në vlerën për 10,349 mijë lekë ose realizuar në masën 95%.

Fondet e alokuara dhe realizuara për, sipas projekteve të shpenzimeve Kapitale me Financim të Brendshëm për vitin 2025, paraqiten si më poshtë

Në mijë lekë

Pershkrimi	Kodi	Ligji i Buxhetit	AN Nr. 10	Realizimi	%
Paisje kompjuterike	M240009	7,000	3,800	3,742	98%
Automjete	M240002	3,870	3,470	3,420	99%
Rikonstruksion godine	M240003	3,130	3,130	2,658	85%
Paisje Zyre	M240010	1,000	550	529	96%
Totali		15,000	10,950	10,349	95%

Për vitin 2025, KLSH ka realizuar procedurat e prokurimit për blerje automjeti, blerje paisje informatike, rikonstruksionin e godinës dhe blerje paisje zyre. Adresimi i fondeve të

investimeve në këto projekte investimi ka ardhur si domosdoshmëri me qëllim vijim normal të aktivitetit auditues të KLSH-së.

5.1 Plani i buxhetit në zërin “Blerje automjeti”, në vlerën për 3,470 mijë lekë është realizuar në vlerën për 3,420 mijë lekë ose në masën 99%.

5.2 Plani i buxhetit në zërin “Blerje pajisje informatike”, kompjuter, laptop në funksion të veprimtarisë audituese në vlerën për 3,800 mijë lekë është realizuar në vlerën për 3,742 mijë lekë ose në masën 98 %.

5.3 Plani i buxhetit në zërin “Rikonstruksion ndërtesa”, në vlerën për 3,130 mijë lekë është realizuar në vlerën për 2,658 mijë lekë. Adresimi i këtyre fondeve në këtë zë ka ardhur si domosdoshmëri, e pëmbushjes së kërkesat e një standardi të punës dhe prezantimin dinjitoz si institucion suprem auditimi, që të jetë në nivelin e kërkesave të kohës, si dhe krijim e ambienteve bashkëkohore për nëpunësit e KLSH-së, si dhe rikonstruksionin e ambienteve të parkut të automjeteve pranë rrugës Don Bosko, me qëllim shfrytëzimin e hapësirave dhe transformimin e garazheve ekzistuese në magazina të KLSH-së.

5.4 Plani i buxhetit në zërin “Blerje pajisje zyre”, bazuar në një rivlerësim të gjendjes së pajisjeve të zyrave (karrike) me qëllim shfrytëzimin në mënyrë eficiente të tyre në vlerën për 550 mijë lekë është realizuar në vlerën për 529 mijë lekë ose në masën 95 %.

- Shpenzime Kapitale me Financim të Huaj.

Bazuar në Ligjin nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, nuk ka patur një plan buxheti me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Huaj në artikullin 230 për zbatimin e projektit “Forcimi i Mbikëqyrjes së Auditimit të Jashtëm për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat në Shqipëri”, financuar nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO). Ky projekt, në vlerën totale për 21,800 mijë lekë, bashkëfinancim u zyrtarizua me firmosen e Marrëveshjes nr. 307, datë 09.03.2020 mes Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit është mbyllur në vitin 2024, dhe përgjatë vitit 2025, është bërë likuidimi i kështit të fundit.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE

KLSH përgjatë vitit 2025 vijoi veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirëfunksionimi të sistemeve të kontrollit të brendshëm duke siguruar përputhshmërinë me standardet e kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE, me detyrimet kushtetuese dhe me pritshmërinë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit.

I. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E KLSH-së

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar. Ai i nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

Misioni

Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucion i pavarur, kushtetues, i cili nëpërmjet ekspertizës dhe auditimeve cilësore, mbështet Kuvendin dhe informon publikun dhe palët e interesit në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në menaxhimin e parasë së taksapaguesve, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike.

Vizioni

KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përmirësimin e shërbimeve publike, nëpërmjet auditimeve cilësore dhe luftës kundër korrupsionit, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni.

Objektivat:

Tre qëllimet strategjike që do të udhëheqin punën e KLSH-së në pesë vitet e ardhshme janë:

1. Rritja dhe përmirësimi i rolit të KLSH si mbështetës i Kuvendit për llogaridhënie efektive dhe shqyrtim të kujdesshëm e të thelluar të enteve përdoruese të fondeve publike.
2. Rritja e impaktit të punës audituese në qeverisjen e mirë, nëpërmjet përmirësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve.
3. Optimizimi i kapaciteteve profesionale me qëllim zotërimin e njohurive inovative në punën audituese.

MBI REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË MENAXHIMIT INSTITUCIONAL.

A-Treguesit kryesore të veprimtarisë audituese.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për vitin 2025, ka vijuar punën audituese në zbatim të planit të miratuar me vendimin nr. 218, datë 15.11.2024, të Kryetarit të KLSH, ka përfunduar kryerjen e misioneve të auditimit referuar planit vjetor të auditimit prej 180 auditimesh, dhe është në fazën përmbyllëse të evadimeve dhe hartimit të raportit vjetor. Këto auditime janë planifikuar në vlerësim të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, performancës, IT dhe ndjekjes së statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në periudha të mëparshme.

Institucionet ku janë kryer auditimet

Në vitin 2025, auditimet e kryera kanë përfshirë vlerësimin e aktivitetit të subjekteve, duke përfshirë nivele të ndryshme të qeverisjes si: institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore, drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, si dhe shoqëri aksionere me kapital shtetëror në të cilat shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj.

Opinionet/mesazhet/konkluzionet sipas llojit të auditimit

Bazuar në planin vjetor të auditimeve për vitin 2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën 2025, auditimet e kryera kanë konkluduar me opinionet e auditimit apo mesazhet e auditimit, si dhe janë adresuar rekomandime për masa organizative, propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore në institucionet publike të audituara, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës. Gjithashtu, bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH, për të metat dhe shkeljet e konstatuara ka adresuar tek subjektet e audituara masa shpërblim dëmi, masa administrative dhe disiplinore.

Nga rezultatet e auditimeve, gjatë kësaj periudhe, gjetjet e konstatuara i referohen:

-Shkelje të disiplinës financiare në ekzekutimin e buxhetit, me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe në përdorimin e fondeve publike.

-Shkelje të konstatuara përgjatë zbatimit të punimeve - likuidime për punime të pakryera. Ndërsa në fushën e të ardhurave, peshën më të madhe e zënë të ardhurat e munguara nga administrimi i pasurisë shtetërore dhe marrëdhëniet kontraktuale me palët e treta

-Mangësi në aktivitetin kontrollues tatimor me ndikim negativ në performancën e administrimit të të ardhurave tatimore & doganore, si detyrime dhe penalitete të vlerësuara.

Sa i takon indikatorit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, në bazë të rezultateve të auditimeve për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve, të kryera gjatë vitit 2025 për rekomandimet e lëna në auditimet e kryera gjatë vitit 2024 dhe periudha të mëparshme, rezulton se shkalla e pranueshmërisë së rekomandime është rreth 100% ndërsa shkalla e zbatueshmërisë rreth 70% duke marrë në konsideratë statusin e zbatimit.

B- Mbi trajnimet dhe bashkëpunimet e realizuara gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, u trajnuan gjithsej 199 auditues, dhe jo - auditues duke realizuar mesatarisht 5195 ditë trajnime në vit, përkatësisht 27.5 ditë njerëz/trajnime/vit për stafin auditues, dhe 21.3 ditë/njerëz trajnime, për stafin jo-auditues.

Sa i takon marrëdhënieve me jashtë dhe bashkëpunimit me palë të treta, përgjatë vitit 2025 janë nënshkruar 2 Memorandume të reja Mirëkuptimi përkatësisht me UN Eomen dhe me Zyrën e Llogarive të Azerbajxhanit, ku kjo e fundit u nënshkrua në kuadër të aktiviteteve të 100 vjetorit.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, gjatë vitit 2025, KLSH është angazhuar në 3 auditime paralele me SAI të tjera, si: SAI i Maqedonisë së Veriut, ZKA Kosovë dhe SAI i Izraelit.

Për më tepër, ka vijuar bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile si NDI, IDM, EFD, etj., ku një ndër produktet më të rëndësishme është përditësimi i Planit të Veprimit të Stratgjisë së Komunikimit me mbështetjen teknike të NAO-s së Mbretërisë së Bashkuar, nën koordinimin e organizatës Westminster Foundation.

Një informacion më i detajuar në lidhje me veprimtarinë e kryer për vitin ushtrimor 2025, do të paraqitet në Raportin e Performancës së KLSH-së për vitin 2025, i cili do të publikohet në faqen zyrtare të KLSH-së.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Valbona Gaxha



ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit

Periodha e Raportimit Viti 2025

në/lekë

Emri i Grupit Kontrollit Lartë i Shtetit		Kodi i grupit 24										
		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit										
		Viti paraardhës 2024		Periodha raportuese		Periodha raportuese		Periodha raportuese	Periodha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve	Plani Fillestar Vjetor Viti 2025	Struktura e shpenzimeve	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025	Struktura e shpenzimeve	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progr	Struktura e shpenzimeve		
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)	11 (8/5)		
EMËRTIME												
Shpenzimet sipas programeve buxhetore												
di i Progra	Emërtimi											
01120	Veprimtaria Audituese e KLSH											
	613,038,160	100	694,273,000	100	644,493,250	100	-49,779,750	633,385,331	100	11,107,919	98%	
	Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise (Kap											
	613,038,160	100	694,273,000	100	644,493,250	100	-56,050,000	633,385,331	100	11,107,919	98%	
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)											
	2,908,165							0				
	Totali Shpenzimeve te Ministrisë											
	615,946,325							633,385,331				
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik												
Artikulli	Emërtimi											
600	Paga	456,120,688	74%	531,300,000	77%	480,300,000	75%	-51,000,000	475,959,900	76%	4,340,100	99%
601	Sigurime Shoqërore	69,813,026	11%	66,800,000	10%	73,800,000	11%	7,000,000	71,703,716	11%	2,096,284	97%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	71,082,162	12%	80,900,000	12%	72,700,000	11%	-8,200,000	69,338,532	11%	3,361,468	95%
603	Subvencione	0	0%	0	0%	0	0%	0	0	0%	0	
604	Transferata Korrente të Brendshme	0	0%	0	0%	0	0%	0	0	0%	0	
605	Transferata Korrente të Huaja	292,166	0%	0	0%	200,000	0%	200,000	100,396	0%	99,604	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,150,880	0%	1,500,000	0%	1,500,000	0%	0	1,163,650	0%	336,350	
	Nen-Totali Shpenzime Korrente	598,458,922	97%	680,500,000	98%	628,500,000	98%	-52,000,000	618,266,194	98%	10,233,806	98%
230	Kapitale të Patrupëzuara	4,007,113	1%	0	0%	0	0%	0	0	1%	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	6,442,475	1%	15,000,000	2%	10,950,000	2%	-4,050,000	10,349,187	2%	600,813	95%
	Nen-Totali Shpenzime Kapitalë me financim te brendshem	10,449,588	2%	15,000,000	2%	10,950,000	2%	-4,050,000	10,349,187	2%	600,813	95%
230	Kapitale të Patrupëzuara	4,129,650	1%	0	0%	0	0%	0	4,769,950	1%	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0%	0	0%	0	0%	0	0	0%	0	
	Nen-Totali Shpenzime Kapitalë me financim te huaj	4,129,650	1%	0	0%	4,769,950	1%		4,769,950	1%	0	
	Totali Shpenzime Kapitalë	14,579,238	2%	15,000,000	2%	15,719,950	2%	-4,050,000	15,119,137	2%	600,813	96%
	Totali i Shpenz. Buxhetore	613,038,160		695,500,000	100%	644,219,950	100%		633,385,331	101%	10,834,619	98%
	Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)											
	2,908,165	0%	273,300		273,300		0	0			0%	
	Totali (Korrente + Kapitalë + Shpenz. nga te ardh. jashte limitit)											
	615,946,325		695,773,300		644,493,250		-56,050,000	633,385,331		10,834,619	98%	
	Numri i punonjësve											
	0		243						214			

Sekretari i Përzijshëm

Vatbona Gaxha

